

UDHËZIM
Nr. 1276/6, datë 27.7.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË
VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR VEPRIMET PËRMBARIMORE TË
OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHETËTËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe neneve 12 dhe 12/b, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. Qëllimi udhëzimit

1. Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave udhëzojnë si më poshtë subjektet e përfshira në një procedurë të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror me synimin:

- a) rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve përmbarimore;
- b) përcaktimin e parimeve për tarifën e suksesit dhe sigurimin e transparencës së llogarive dhe arkëtimit gjatë ofrimit të shërbimit përmbarimor;
- c) ndërveprimin shkakësor të përfitimit financiar me cilësinë e shërbimit;
- d) mbrojtjen e interesave të palës kreditore/kërkuese dhe sigurimi i trajtimit të barabartë të tyre, duke u bazuar në përfitueshmërinë e ndërsjellë.

II. Rregulla të përgjithshme mbi aplikimin e tarifës së suksesit

1. Masa e tarifës së suksesit është shprehje e vullnetit të palës kreditore dhe përmbaruesit gjyqësor dhe përcaktohet me marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit. Marrëveshja me të cilën caktohet tarifa e suksesit, e nënshkruar rregullisht midis kreditorit dhe subjektit përmbarues, bëhet pjesë integrale e kontratës së shërbimit përmbarimor, duke pasur të njëjtën fuqi ligjore me kontratën.

2. Marrëveshja për aplikimin e tarifës së suksesit që nënshkruhet ndërmjet kreditorit dhe subjektit përmbarues, duhet të nënshkruhet sipas formatit “tip”, miratuar me urdhër të veçantë nga ministri i Drejtësisë.

3. Marrëveshja sipas modelit “tip” të miratuar, në të cilën përcaktohet tarifa e suksesit, nënshkruhet nga kreditori/kërkuesi dhe kryetari i Zyrës Përmbarimore në të cilën është paraqitur kërkesa për ekzekutim.

4. Pala kreditore dhe subjekti përmbarues përcaktojnë vlerën konkrete, brenda nivelit minimal dhe maksimal të vlerës së tarifës së suksesit përcaktuar në këtë udhëzim, bazuar në kriteret e mëposhtme si:

- a) shumën totale të detyrimit;
- b) kohën e ekzekutimit nga ana e subjektit përmbarues;
- c) shpejtësinë e kryerjes së veprimeve përmbarimore, brenda afateve maksimale ligjore;
- d) përcaktimin e veprimeve apo rezultateve alternative që konsiderohen në mënyra të ndryshme si sukses, duke përllogaritur tarifa alternative suksesi;
- e) përcaktimin e nivelit minimal të arkëtimit të detyrimit, që do të konsiderohet si sukses nga palët;
- f) sekuestrimin dhe/ose ekzekutimin e sendeve në pronësi të palës debitore, përveç pasurive të hipotekuara nga pala debitore si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimit.

5. Masa e tarifës së suksesit të përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar midis kreditorit dhe subjektit përmbarues, duhet të respektojë nivelin minimal dhe maksimal të aplikimit të saj, sipas përcaktimit në këtë udhëzim.

6. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar nga kreditori dhe Zyrës Përmbarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe

nuk i ngarkohet debitorit.

7. Në çdo rast, tarifës së suksesit i ngarkohet TVSH-ja, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë të tarifës së suksesit e cila arkëtohet nga përmblyesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

8. Tarifa e suksesit aplikohet vetëm me vullnetin e palëve, të formalizuar në marrëveshje, përlllogarit dhe faturohet pjesërisht apo plotësisht nga Zyra Përmblyimore, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.

9. Drejtori i Përgjithshëm i Përmblyimit miraton me urdhër metodologjinë mbi mënyrën e negocimit dhe parashikimit të masës konkrete të tarifës së suksesit, të specifikuara sipas rasteve dhe objektit, që do të duhet të aplikohet apo pranohet nga kryetari i Zyrës Përmblyimore.

III. Tarifa e suksesit e përlllogaritur mbi bazën e shumës së ekzekutuar

1. Kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar, pala kreditore dhe subjekti përmblyues, sipas vullnetit të tyre, mund të parashikojnë në marrëveshje masën e tarifës së suksesit, por në çdo rast kjo tarifë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10% e vlerës së ekzekutuar të detyrimit.

2. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë për shumën e ekzekutuar në llogarinë e saj, si dhe t'i paguajë subjektin përmblyues tarifën e suksesit për shërbimin e arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur, jo më vonë se 30 ditë nga momenti i realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar. Në rast se ekzekutimi i shumës së detyrimit monetar kryhet nëpërmjet llogarisë bankare të subjektit përmblyues, pagesa/faturimi i tarifës së suksesit do të bëhet pas kreditimit të kësaj pagese në llogarinë e palës kreditore/kërkuesit.

3. Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe përmblyesit gjyqësor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:

a) Për mbledhjen e suksesshme të detyrimit apo ekzekutimin e suksesshëm të titujve ekzekutivë me objekt të vlefshueshëm për një vlerë detyrimi deri në 500 000 lekë – nuk mund të jetë më e vogël se 3% dhe jo më e madhe se 10% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose të detyrimit të ekzekutuar.

b) Për mbledhjen e suksesshme të detyrimit apo ekzekutimin e suksesshëm të titujve ekzekutivë me objekt të vlefshueshëm për një vlerë detyrimi mbi 500 001 lekë deri në 90 000 000 lekë – nuk mund të jetë më e vogël se 2% dhe jo më e madhe se 7% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose të detyrimit të ekzekutuar.

c) Për mbledhjen e suksesshme të detyrimit apo ekzekutimin e suksesshëm të titujve ekzekutivë me objekt të vlefshueshëm për një vlerë detyrimi mbi 90 000 001 lekë – nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 3% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose të detyrimit të ekzekutuar, por jo më shumë se 7.000.000 lekë.

IV. Tarifa e suksesit e përlllogaritur mbi bazën e veprimeve përmblyimore të kryera

1. Vlera e tarifës së suksesit të shërbimit përmblyimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përlllogaritet në varësi të:

a) vendit të ekzekutimit;

b) objektit të ekzekutimit;

c) kohës së kryerjes së veprimit përmblyimor dhe/ose përsëritjes së këtij veprimi përmblyimor.

2. Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmblyimore të kryera do të jetë një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

V. Kombinimi i tarifës së suksesit

1. Pala kreditore dhe subjekti përmblyues mund të bien dakord në përputhje me marrëveshjen “tip” të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, aplikimin e tarifës në mënyrë të kombinuar, mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar, por gjithmonë shumën e tarifës së suksesit e kombinuar nuk duhet të kalojë shumën që do të aplikohet në aplikimin e secilës metodë tarifimi më vete.

VI. Ndarja e të ardhurave, kriteret e procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave,

mbledhja dhe përdorimi i tyre, bëhet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 33, datë 29.12.2014, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, si dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

VII. Ky udhëzim rregullon marrëdhëniet midis palës kreditore dhe subjektit përmbarues, të lindura pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË

Gazment Bardhi

MINISTRI I FINANCEVE

Helga Vukaj